



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE

V E N D I M

Nr. 1132, datë 24.12.2020

P Ë R

**NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.202, DATË 5.3.2020,
TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR PËRDORIMIN E FONDIT
TË RINDËRTIMIT, PËR FINANCIMIN E RINDËRTIMIT
TË BANESAVE INDIVIDUALE, NDËRTIMIN
DHE RIKONSTRUKSIONIN E INFRASTRUKTURËS PUBLIKE,
SI DHE ÇDO NDËRHYRJE TJETËR NË FUNKSION
TË RINDËRTIMIT TË KËTYRE BANESAVE", TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 13, shkronja "b", nënndarja "i", 16, pika 3, dhe 36, pika 1, shkronja "a", të aktit normativ nr.9, datë 16.12.2019, të Këshillit Ministrave, "Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore", miratuar me ligjin nr.97/2019, të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, dhe të ligjit nr.88/2019, "Për buxhetin e vitit 2020", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Shtetit për Rindërtimin, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Pika 2.1, e vendimit nr.202, datë 5.3.2020, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, ndryshohet, si më poshtë vijon:

"2.1. Fondi që do të përdoret, i miratuar në buxhetin e vitit 2020, do të jetë 3 757 881 137 (tre miliardë e shtatëqind e pesëdhjetë e shtatë milionë e tetëqind e tetëdhjetë e një mijë e njëqind e tridhjetë e shtatë) lekë pa TVSH, nga i cili:

- a) Fondit Shqiptar të Zhvillimit, në buxhetin e miratuar për vitin 2020, në zërin "Shpenzime kapitale me financim të brendshëm", të programit 06210 "Programe zhvillimi", i shtohet fondi prej 2 492 978 390 (dy miliardë e katërqind e nëntëdhjetë e dy milionë e nëntëqind e

shtatëdhjetë e tetë mijë e treqind e nëntëdhjetë) lekësh pa TVSH, për financimin e rindërtimit të banesave individuale, brenda dhe jashtë zonave të reja për zhvillim, ndërtimin dhe rikonstrukcionin e infrastrukturës publike si dhe çdo ndërhyrje tjetër, në funksion të rindërtimit të banesave individuale, jashtë zonave të reja për zhvillim.

b) Bashkisë Tiranë i transferohet fondi prej 1 264 902 747 (një miliard e dyqind e gjashtëdhjetë e katër milionë e nëntëqind e dy mijë e shtatëqind e dyzet e shtatë) lekësh pa TVSH, në formën e transfertës së pakushtëzuar, për financimin e rindërtimit të banesave individuale, brenda dhe jashtë zonave të reja për zhvillim, ndërtimin dhe rikonstrukcionin e infrastrukturës publike, si dhe çdo ndërhyrje tjetër, në funksion të rindërtimit të banesave individuale, jashtë zonave të reja për zhvillim.”.

2. Ngarkohen ministri i Shtetit për Rindërtimin, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Fondi Shqiptar i Zhvillimit dhe Bashkia Tiranë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në “Fletoren zyrtare”.

K R Y E M I N I S T R I

EDI RAMA

Në mungesë dhe me porosi

ZËVENDËSKRYEMINISTRI

ERION BRACE

MINISTRI I SHTETIT
PËR RINDËRTIMIN

ARBËN AHMETAJ

NR.PROT. 6593/1
DATE 31.12. 2020

MINISTRIT TË SHPETIT PËR RINDËRTIMIN
MINISTRISË SË FINANCAVE DHE EKONOMISË
FONDIT SHQIPTAR TË ZHVILLIMIT
BASHKISË TIRANË
QENDRËS SË BOTIMEVE ZYRTARE

Sekretari i Përgjithshëm

Engjëll AGACI

